



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/06
Datë: 13.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për çështjen e pasurisë së fituar në mënyrë të pajustificueshme.
2. Obligohen Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/06
Datë: 13.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.06/L-091.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/06
Datë: 13.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi (4) dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 dhe 50 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

**PËR THEMELIMIN E STRUKTURAVE KOORDINUESE NDËR-INSTITUCIONALE
PËR PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN**

Neni 1

Qëllimi i vendimit

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i përbërjes së fushëveprimit dhe mënyrës së punës së strukturave koordinuese ndër-institucionale të Republikës së Kosovës për procesin e integrimit evropian.
2. Strukturat koordinuese ndër-institucionale për procesin e integrimit evropian janë:
 - 2.1. Këshilli Ministror për Integrim Evropian (në tekstin e mëtejme, KMIE);
 - 2.2. Komiteti Punues për Integrim Evropian (në tekstin e mëtejme, KPIE); dhe
 - 2.3. Grupet Punuese Sektoriale për Integrim Evropian (në tekstin e mëtejme, GPSIE).

Neni 2

Këshilli Ministror për Integrim Evropian

1. Në funksion të zbatimit të reformave për integrim në Bashkimin Evropian (në tekstin e mëtejme, BE) dhe bazuar në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (në tekstin e mëtejme, MSA) dhe mekanizmat e tjerë të stabilizim-asociimit, KMIE ushtron këto funksione:
 - 1.1. Shqyrton, diskuton dhe i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme, Qeverisë) politikat shtetërore për zbatimin e reformave për procesin e integrimit në BE si dhe qëndrimet negociuese shtetërore, duke përfshirë përafrimin e legjislacionit vendor me *acquis* të BE-së dhe ndihmën e BE-së dhe partnerëve të tjerë zhvillimor në proces të para-anëtarësimit;

- 1.2. Shqyrton dhe diskuton ecurinë e zbatimit të prioriteteve politike dhe të dokumenteve shtetërore për procesin e integrimit në BE, si dhe nxjerr rekomandime për Qeverinë dhe institucione të tjera lidhur me masat konkrete që kërkojnë vendimmarrje politike për sigurimin e zbatimit të tyre;
 - 1.3. Shqyrton, diskuton dhe nxjerr rekomandime për Qeverinë dhe institucionet e tjera shtetërore lidhur me bashkëpunimin me Kuvendin e Republikës së Kosovës, institucionet e sistemit të drejtësisë dhe institucione të tjera të pavarura, për të siguruar përmbushjen e obligimeve të marra përsipër në kuadër të procesit të integrimit evropian;
 - 1.4. Shqyrton, diskuton dhe nxjerr rekomandime për Qeverinë dhe institucionet e tjera shtetërore lidhur me bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesuara, për të siguruar përmbushjen e obligimeve të marra përsipër në kuadër të procesit të integrimit evropian;
 - 1.5. Shqyrton, diskuton dhe nxjerr rekomandime për Qeverinë dhe institucionet e tjera shtetërore lidhur me bashkëpunimin me institucionet e BE-së dhe shtetet e tij anëtare, si dhe iniciativat e mekanizmat e tjerë në BE, për të siguruar përmbushjen e obligimeve të marra përsipër në kuadër të procesit të integrimit evropian;
 - 1.6. Shqyrton, diskuton dhe nxjerr rekomandime për Qeverinë dhe institucionet e tjera shtetërore lidhur me bashkëpunimin rajonal dhe dypalësh me shtetet e tjera që gjenden në procesin e stabilizim-asociimit, për të siguruar përmbushjen e obligimeve të marra përsipër në kuadër të procesit të integrimit evropian.
2. KMIE ka këtë përbërje:
 - 2.1. Kryeministri, Kryesues;
 - 2.2. Zëvendëskryeministri përgjegjës për integrim evropian, Zëvendës-kryesues;
 - 2.3. Ministri përgjegjës për punë të jashtme, anëtar;
 - 2.4. Ministri përgjegjës për financa, anëtar;
 - 2.5. Ministri përgjegjës për industri, ndërmarrësi dhe tregti, anëtar;
 - 2.6. Ministri përgjegjës për drejtësi, anëtar;
 - 2.7. Ministri përgjegjës për energji dhe mjedis, anëtar.
 3. Nëse kërkohet sipas rendit të ditës, Kryesuesi mund të ftojë për të marrë pjesë në mbledhje ministra të tjerë, si dhe udhëheqës të institucioneve të tjera të Qeverisë dhe atyre të pavarura.
 4. Kryesuesi mund të ftojë për të marrë pjesë në mbledhje, përfaqësues të institucioneve të BE-së dhe shteteve anëtare, përfshirë përfaqësitë e tyre të akredituara në Republikën e Kosovës, si dhe përfaqësues të partnerëve zhvillimor.
 5. Në mbledhje marrin pjesë po ashtu edhe Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, si dhe përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit, përkatësisht Zyra për Koordinimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit, Zyra për Kriteret Politike, Zyra për Kriteret Ekonomike dhe Tregun e Brendshëm, Zyra për Politikat Sektoriale, Zyra e Bashkëpunimit për Zhvillim dhe Zyra Ligjore.
 6. Në mbledhje marrin pjesë edhe Sekretarët e Përgjithshëm të ministrive pjesëmarrëse dhe zyrtarë ekuivalentë të institucioneve të tjera, si dhe zyrtarët e departamenteve përkatëse të ministrive pjesëmarrëse, sipas rendit të ditës.
 7. KMIE mban mbledhje të paktën një herë në tre muaj, apo edhe më shpesh me ftesë të Kryesuesit ose Zëvendës-kryesuesit.

8. Sekretariat i KMIE-së është Zyra për Koordinimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Sekretariati është përgjegjës për organizimin e punës së KMIE-së, dhe kryen këto detyra:
 - 8.1. Përgatit dhe shpërndan rendin e ditës së mbledhjeve;
 - 8.2. Organizon mbledhjet;
 - 8.3. Siguron ndihmë teknike gjatë mbledhjeve;
 - 8.4. Përgatit procesverbalet, konkluzionet dhe materialet e tjera të mbledhjeve;
 - 8.5. U shpërndan materialet e mbledhjeve anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje, si dhe palëve të tjera relevante;
 - 8.6. Mban arkivin e materialeve të mbledhjeve;
 - 8.7. I ofron mbështetje KMIE-së në kryerjen e funksioneve të tij;
 - 8.8. Monitoron zbatimin e konkluzioneve të KMIE-së dhe vendimeve të Qeverisë në zbatim të tyre, dhe me kërkesën e tij ia dorëzon rezultatet e monitorimit për diskutime të mëtutjeshme dhe ndërmarrjen e veprimeve të domosdoshme.
9. Sekretariati kryen detyrat e tij në bashkëpunim me Kryesuesin, anëtarët, si dhe me shërbime të tjera përkatëse të Qeverisë dhe palët e tjera, sipas nevojës.

Neni 3

Komiteti Punues për Integrim Evropian

1. KPIE është strukturë koordinuese ndër-institucionale në nivel të Sekretarëve të Përgjithshëm të Qeverisë dhe udhëheqësve të tjerë të lartë në shërbimin civil, të cilët, brenda spektrit të funksioneve dhe të të drejtave të veta, sigurojnë bashkëpunimin e ministrive dhe institucioneve tjera shtetërore në zbatimin e reformave për procesin e integritit evropian.
2. Në funksion të zbatimit të reformave për procesin e integritit në BE dhe bazuar në MSA dhe mekanizmat e tjerë të stabilizim-asociimit, KPIE ushtron këto funksione:
 - 2.1. Ofron propozime për KMIE lidhur me politikat shtetërore për zbatimin e reformave për procesin e integritit në BE si dhe qëndrimet negociuese shtetërore, duke përfshirë përafrimin e legjislacionit vendor me *acquis* të BE-së dhe ndihmën e BE-së dhe partnerëve të tjerë zhvillimor në proces të para-anëtarësimit;
 - 2.2. Diskuton dhe adreson çështjet lidhur me ndarjen e përgjegjësive dhe bashkëpunimin ndërmjet ministrive dhe institucioneve të tjera lidhur me planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e prioriteteve politike dhe të dokumenteve shtetërore për procesin e integritit në BE, dhe nxjerr rekomandime për KMIE lidhur me çështjet që kërkojnë vendimmarrje politike për këtë qëllim;
 - 2.3. Diskuton raportet e rregullta mbi zbatimin e prioriteteve politike dhe të dokumenteve shtetërore për procesin e integritit në BE, përfshirë dhe adresimin e pengesave e mangësive në nivel të shërbimit civil, si dhe nxjerr rekomandime për KMIE-në dhe vendimmarrës të nivelit politik lidhur me çështjet që kërkojnë vendimmarrje politike;
 - 2.4. Diskuton lidhur me bashkëpunimin e Qeverisë me Kuvendin, institucionet e sistemit të drejtësisë dhe institucione të tjera të pavarura për zbatimin e reformave për procesin e integritit në BE, si dhe nxjerr rekomandime për KMIE-në lidhur me çështjet që kërkojnë vendimmarrje politike;
 - 2.5. Diskuton lidhur me bashkëpunimin e Qeverisë me shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesuara për zbatimin e reformave për procesin e integritit në BE, si dhe nxjerr rekomandime për KMIE-në lidhur me çështjet që kërkojnë vendimmarrje politike.

3. KPIE ka këtë përbërje:

- 3.1. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, Kryesues;
 - 3.2. Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse për punë të jashtme, anëtar;
 - 3.3. Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse për financa, anëtar;
 - 3.4. Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse për industri, ndërmarrësi dhe tregti, anëtar;
 - 3.5. Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse për drejtësi, anëtar;
 - 3.6. Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë përgjegjëse për energji dhe mjedis, anëtar;
 - 3.7. Drejtori i Zyrës Ligjore në Zyrën e Kryeministrit, anëtar;
 - 3.8. Drejtori i Zyrës për Koordinimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit, anëtar;
 - 3.9. Drejtori i Zyrës për Kriteret Politike, anëtar;
 - 3.10. Drejtori i Zyrës për Kriteret Ekonomike dhe Tregun e Brendshëm, anëtar;
 - 3.11. Drejtori i Zyrës për Politikat Sektoriale, anëtar; dhe
 - 3.12. Drejtori i Zyrës së Bashkëpunimit për Zhvillim.
4. Nëse kërkohet sipas rendit të ditës, Kryesuesi mund të ftojë për të marrë pjesë në mbledhje zyrtarë të institucioneve të tjera të Qeverisë dhe të institucioneve të pavarura.
5. Kryesuesi mund të ftojë për të marrë pjesë në mbledhje zyrtarë të institucioneve të BE-së, si dhe nga partnerët për zhvillim.
6. Në mbledhje marrin pjesë zyrtarë të departamenteve përkatëse të ministrive pjesëmarrëse, sipas rendit të ditës.
7. KPIE mban mbledhje të paktën një herë në tre muaj, por mund të mbajë mbledhje edhe më shpesh me ftesë të Kryesuesit.
8. Sekretariat i KPIE-së është Zyra për Koordinimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Sekretariati është përgjegjës për organizimin e punës së KPIE-së, dhe kryen këto detyra:
- 8.1. Përgatit dhe të shpërndan rendin e ditë së mbledhjeve;
 - 8.2. Organizon mbledhjet;
 - 8.3. Siguron ndihmë teknike gjatë mbledhjeve;
 - 8.4. Përgatit procesverbalet, konkluzionet dhe materialet e tjera të mbledhjeve;
 - 8.5. U shpërndan materialet e mbledhjeve anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje, si dhe palëve të tjera relevante;
 - 8.6. Mban arkivin e materialeve të mbledhjeve;
 - 8.7. I ofron mbështetje KPIE-së në kryerjen e funksioneve të tij;
 - 8.8. Monitoron zbatimin e konkluzioneve të KPIE-së, dhe me kërkesën e tij ia dorëzon rezultatet e monitorimit për diskutime të mëtutjeshme dhe ndërmarrjen e veprimeve të domosdoshme.
9. Sekretariati kryen detyrat e tij në bashkëpunim me Kryesuesin, anëtarët dhe shërbimet e tjera përkatëse të Qeverisë dhe palë të tjera, sipas nevojës.

Neni 4

Funksionet dhe mënyra e punës e Grupeve Punuese Sektoriale për Integrim Evropian

1. GPSIE-të janë struktura koordinuese ndër-institucionale në nivel të drejtorëve të departamenteve brenda sektorëve përkatës, të cilët, brenda spektrit të funksioneve dhe të mandatit të tyre, koordinojnë aktivitetet e përditshme në zbatimin e reformave për procesin e integritimit në BE.

2. Në kuadër të sektorëve që mbulojnë, GPSIE-të ushtrojnë këto funksione:

- 2.1. Diskutojnë dhe përpunojnë propozimet e ministrive dhe institucioneve të tjera shtetërore lidhur me politikat shtetërore për zbatimin e reformave për procesin e integritimit në BE dhe qëndrimet negociuese shtetërore, si dhe ofrojnë rekomandimet përkatëse për KPIE-në dhe struktura të tjera institucionale në nivel më të lartë duke përfshirë përafrimin e legjislacionit vendor me *acquis* të BE-së dhe ndihmën e BE-së dhe partnerëve të tjerë zhvillimorë në proces të para-anëtarësimit;
 - 2.2. Diskutojnë dhe adresojnë çështjet lidhur me ndarjen e përgjegjësive dhe bashkëpunimin ndërmjet ministrive dhe institucioneve të tjera, në nivel të departamenteve, lidhur me planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve në kuadër të prioriteteve politike dhe të dokumenteve shtetërore për procesin e integritimit në BE, si dhe ofrojnë propozimet përkatëse për KPIE-në dhe struktura të tjera institucionale në nivel më të lartë;
 - 2.3. Diskutojnë raportet e rregullta mbi zbatimin e prioriteteve politike dhe të dokumenteve shtetërore për procesin e integritimit në BE, përfshirë identifikimin dhe adresimin e pengesave e mangësive në nivel të aktiviteteve, si dhe ofrojnë propozimet përkatëse për KPIE-në dhe struktura të tjera institucionale në nivel më të lartë;
 - 2.4. Diskutojnë rregullisht ecurinë e aktiviteteve të ndërlidhura me Kuvendin, përfshirë identifikimin dhe adresimin e pengesave në këtë drejtim, si dhe ofrojnë propozimet përkatëse për KPIE-në dhe struktura të tjera institucionale në nivel më të lartë;
 - 2.5. Diskutojnë rregullisht ecurinë e aktiviteteve për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe palët e tjera të interesuara për zbatimin e reformave për procesin e integritimit në BE, si dhe ofrojnë propozimet përkatëse për KPIE-në dhe struktura të tjera institucionale në nivel më të lartë.
3. Të gjitha GPSIE-të kryesohen nga drejtorët e zyrave përgjegjëse në Zyrën e Kryeministrit të përcaktuar me këtë vendim.
 4. Nëse kërkohet sipas rendit të ditës, Kryesuesi mund të ftojë për të marrë pjesë në mbledhje zyrtarë të institucioneve të tjera të Qeverisë dhe të institucioneve të pavarura.
 5. Kryesuesi mund të ftojë për të marrë pjesë në mbledhje zyrtarë të institucioneve të BE-së, si dhe nga partnerët për zhvillim.
 6. Në mbledhje marrin pjesë zyrtarë të Zyrës së Kryeministrit, përkatësisht Zyra për Koordinimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit, Zyra për Kriteret Politike, Zyra për Kriteret Ekonomike dhe Tregun e Brendshëm, Zyra për Politikat Sektoriale, Zyra e Bashkëpunimit për Zhvillim dhe Zyra Ligjore.
 7. Në mbledhje marrin pjesë zyrtarë të departamenteve përkatëse të ministrive pjesëmarrëse, sipas rendit të ditës.
 8. GPSIE-të mbajnë mbledhje të paktën një herë në tre muaj. Mbledhjet mund të mbahen më shpesh, me ftesë të Kryesuesit.
 9. Sekretariat i secilit GPSIE përcaktohet sipas këtij vendimi dhe ka detyrat si në vijim:
 - 9.1. Organizon mbledhjet;
 - 9.2. Siguron ndihmë teknike gjatë mbledhjeve;
 - 9.3. Përgatit procesverbalet, konkluzionet dhe materialet e tjera të mbledhjeve;
 - 9.4. U shpërndan materialet e mbledhjeve anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje, si dhe palëve të tjera relevante;
 - 9.5. Mban arkivin e materialeve të mbledhjeve;
 - 9.6. I ofron mbështetje GPSIE-së në kryerjen e funksioneve të tij;

- 9.7. Monitoron zbatimin e konkluzioneve të GPSIE-së, dhe me kërkesën e tij ia dorëzon rezultatet e monitorimit për diskutime të mëtutjeshme dhe ndërmarrjen e veprimeve të domosdoshme.
10. Sekretariati kryen detyrat e tij në bashkëpunim me Kryesuesin, anëtarët dhe shërbimet e tjera përkatëse të Qeverisë dhe palë të tjera, sipas nevojës.
11. Grupet Punuese Sektoriale për Integrim Evropian janë si në vijim:
 - 11.1. GPSIE për Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime;
 - 11.2. GPSIE për Bujqësi dhe Peshkatari;
 - 11.3. GPSIE për Treg të Brendshëm dhe Konkurrencë;
 - 11.4. GPSIE për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika;
 - 11.5. GPSIE për Qeverisje;
 - 11.6. GPSIE për Inovacion, Shoqëri të Informacionit dhe Politika Sociale; dhe
 - 11.7. GPSIE për Transport, Energji, Mjedis dhe Zhvillim Rajonal.

Neni 5

Grupi Punues Sektorial për Integrim Evropian për Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime

1. Në përputhje me nenin 4.2 të këtij vendimi, fushëveprimi i GPSIE për Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime mbulon këto fusha:
 - 1.1. Lëvizja e lirë e mallrave (neni 20 i MSA-së);
 - 1.2. Produktet industriale (nenet 21-25 të MSA-së);
 - 1.3. Çështjet tregtare (nenet 36-49 të MSA-së);
 - 1.4. Standardizimi, metrologjia, akreditimi, certifikimi, vlerësimi i konformitetit dhe mbikëqyrja e tregut (neni 80 i MSA-së);
 - 1.5. Bashkëpunimi industrial (neni 99 i MSA-së);
 - 1.6. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (neni 100 i MSA-së);
 - 1.7. Turizmi (neni 101 i MSA-së);
 - 1.8. Doganat (neni 104 i MSA-së);
 - 1.9. Tatimet (neni 105 i MSA-së);
 - 1.10. Rregullat e origjinës (protokolli III i MSA-së);
 - 1.11. Asistenca administrative në çështje doganore (protokolli IV i MSA-së).
2. Në përputhje me nenin 4.1 të këtij vendimi, GPSIE për Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime ka këtë përbërje:
 - 2.1. Drejtori i Zyrës për Kriteret Ekonomike dhe Tregun e Brendshëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Kryesues;
 - 2.2. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për industri, ndërmarrësi dhe tregti, Zëvendës-Kryesues;
 - 2.3. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financa, anëtar.
3. Sekretariat i GPSIE për Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime është Zyra për Kriteret Ekonomike dhe Tregun e Brendshëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 6

Grupi Punues Sektorial për Integrim Evropian për Bujqësi dhe Peshkatari

1. Në përputhje me nenin 4.2 të këtij vendimi, fushëveprimi i GPSIE për Bujqësi dhe Peshkatari mbulon këto fusha:
 - 1.1. Produktet bujqësore (neni 26, 28, 29, 33, 34 dhe 37 i MSA-së);
 - 1.2. Produktet e peshkatarisë (neni 31 dhe 32, dhe shtojca IV dhe V e MSA-së);
 - 1.3. Produktet e përpunuara bujqësore (neni 27 dhe protokollin I i MSA-së);
 - 1.4. Verërat (neni 30 dhe protokollin II i MSA-së);
 - 1.5. Mbrojtja e treguesve gjeografikë për produkte të bujqësisë dhe peshkatarisë dhe ushqimet e tjera përveç verërave dhe pijeve alkoolike (neni 35 i MSA-së);
 - 1.6. Sektori i bujqësisë dhe industrisë bujqësore (agro-industrisë), çështjet e veterinarisë dhe fitosanitare (neni 102 i MSA-së);
 - 1.7. Bashkëpunimi në fushën e peshkatarisë (neni 103 i MSA-së).
2. Në përputhje me nenin 4.1 të këtij vendimi, GPSIE për Bujqësi dhe Peshkatari ka këtë përbërje:
 - 2.1. Drejtori i Zyrës për Politikën Sektoriale në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Kryesues;
 - 2.2. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, anëtar;
 - 2.3. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për industri, ndërmarrësi dhe tregti, anëtar;
 - 2.4. Përfaqësues nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë; anëtar.
3. Sekretariat i GPSIE për Bujqësi dhe Peshkatari është Zyra për Politikën Sektoriale në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 7

Grupi Punues Sektorial për Integrim Evropian për Treg të Brendshëm dhe Konkurrencë

1. Në përputhje me nenin 4.2 të këtij vendimi, fushëveprimi i GPSIE për Treg të Brendshëm dhe Konkurrencë mbulon këto fusha:
 - 1.1. E drejta e themelimit (neni 50-54 i MSA-së);
 - 1.2. Liria e ofrimit të shërbimeve (neni 55-60 i MSA-së);
 - 1.3. Çështjet tjera të ndërlidhura me Titullin V të MSA-së (neni 61-73 i MSA);
 - 1.4. Përafrimi dhe zbatimi i legjislacionit (neni 74 i MSA);
 - 1.5. Konkurrenca (nenet 75-76 i MSA-së);
 - 1.6. Pronësia intelektuale, Industriale dhe komerciale (nenet 77-78 të MSA-së);
 - 1.7. Prokurimi publik (neni 79 i MSA-së);
 - 1.8. Bankat, sigurimet dhe shërbimet tjera financiare (neni 96 i MSA-së);
 - 1.9. Mbrojtja e konsumatorit (neni 81 i MSA-së).
2. Në përputhje me nenin 4.1 të këtij vendimi, GPSIE për Treg të Brendshëm dhe Konkurrencë ka këtë përbërje:
 - 2.1. Drejtori i Zyrës për Kriteret Ekonomike dhe Tregun e Brendshëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Kryesues;
 - 2.2. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për industri, ndërmarrësi dhe tregti, anëtar;
 - 2.3. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financa, anëtar;
 - 2.4. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për kulturë, rini dhe sport, anëtar.
3. Sekretariat i GPSIE për Treg të Brendshëm dhe Konkurrencë është Zyra për Kriteret Ekonomike dhe Tregun e Brendshëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 8

Grupi Punues Sektorial për Integrim Evropian për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika

1. Në përputhje me nenin 4.2 të këtij vendimi, fushëveprimi i GPSIE për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika mbulon këto fusha:
 - 1.1. Pagesat dhe liria e lëvizjes së kapitalit (nenet 64-66 të MSA-së);
 - 1.2. Politika ekonomike (neni 94 i MSA-së);
 - 1.3. Bashkëpunimi statistikor (neni 95 i MSA-së);
 - 1.4. Promovimi dhe mbrojtja e investimeve (neni 98 i MSA-së);
 - 1.5. Bashkëpunimi financiar (nenet 121-125 të MSA-së).
2. Në përputhje me nenin 4.1 të këtij vendimi, GPSIE për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika ka këtë përbërje:
 - 2.1. Drejtori i Zyrës për Kriteret Ekonomike dhe Tregun e Brendshëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Kryesues;
 - 2.2. Përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për financa, anëtar;
 - 2.3. Përfaqësues nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, anëtar;
 - 2.4. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për industri, ndërmarrësi dhe tregti.
3. Sekretariat i GPSIE për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika është Zyra për Kriteret Ekonomike dhe Tregun e Brendshëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 9

Grupi Punues Sektorial për Integrim Evropian për Qeverisje

1. Në përputhje me nenin 4.2 të këtij vendimi, fushëveprimi i GPSIE për Qeverisje mbulon këto fusha:
 - 1.1. Sundimi i ligjit (neni 83 i MSA-së);
 - 1.2. Të drejtat themelore, masat kundër diskriminimit dhe mbrojtja e të dhënave (neni 4 dhe 83 i MSA-së);
 - 1.3. Bashkëpunimi gjyqësor në çështje penale dhe civile (neni 84 i MSA-së);
 - 1.4. Viza, kontrolli kufitar, azili dhe migracioni (nenet 85-86 të MSA-së);
 - 1.5. Parandalimi dhe kontrollimi i migracionit ilegal, dhe riatdhesimi (nenet 87-88 i MSA-së);
 - 1.6. Shpëlarja e parave (neni 89 i MSA-së);
 - 1.7. Drogat (neni 90 i MSA-së);
 - 1.8. Luftimi i terrorizmit (neni 92 i MSA-së);
 - 1.9. Parandalimi i krimit të organizuar dhe aktiviteteve tjera ilegale (neni 91 i MSA-së);
 - 1.10. Reforma e administratës publike (neni 120 i MSA-së);
 - 1.11. Përmirësimi i qëndrueshëm të marrëdhënieve me Serbinë, dhe bashkëpunimin efektiv me misionin e Politikës të Përbashkët të Mbrojtjes dhe Sigurisë të BE-së (neni 5 dhe 13 i MSA-së).
2. Në përputhje me nenin 4.1 të këtij vendimi, GPSIE për Qeverisje ka këtë përbërje:
 - 2.1. Drejtori i Zyrës për Kriteret Politike, Kryesues;
 - 2.2. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punë të jashtme, anëtar;
 - 2.3. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për drejtësi, anëtar;
 - 2.4. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financa; anëtar;
 - 2.5. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punë të brendshme dhe administratë publike, anëtar.

3. Sekretariat i GPSIE për Qeverisje është Zyra për Kriteret Politike në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 10

Grupi Punues Sektorial për Integrim Evropian për Inovacion, Shoqëri të Informacionit dhe Politika Sociale

1. Në përputhje me nenin 4.2 të këtij vendimi, fushëveprimi i GPSIE për Inovacion, Shoqëri të Informacionit dhe Politika Sociale mbulon këto fusha:
 - 1.1. Kushtet e punës dhe mundësitë e barabarta (neni 82 i MSA-së);
 - 1.2. Bashkëpunimi social (neni 106 i MSA-së);
 - 1.3. Edukimi dhe trajnimi (neni 107 i MSA-së);
 - 1.4. Bashkëpunimi kulturor (neni 108 i MSA-së);
 - 1.5. Informimi dhe komunikimi (neni 105 i MSA-së);
 - 1.6. Bashkëpunimi në fushën audio-vizuale (neni 109 i MSA-së);
 - 1.7. Shoqëritë informative (neni 110 i MSA-së);
 - 1.8. Rrjetet e komunikimeve elektronike dhe shërbimet (neni 111 i MSA-së);
 - 1.9. Informacioni dhe komunikimi (neni 112 i MSA-së);
 - 1.10. Hulumtimet shkencore dhe zhvillimi teknologjik (neni 118 i MSA-së).
2. Në përputhje me nenin 4.1 të këtij vendimi, GPSIE për Inovacion, Shoqëri të Informacionit dhe Politika Sociale ka këtë përbërje:
 - 2.1. Drejtori i Zyrës për Kriteret Ekonomike dhe Tregun e Brendshëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Kryesues;
 - 2.2. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsim, shkencë dhe teknologji;
 - 2.3. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punë dhe mirëqenie sociale, anëtar;
 - 2.4. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për kulturë, rini dhe sport, anëtar;
 - 2.5. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonomi, anëtar;
 - 2.6. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punë të brendshme dhe administratë publike, anëtar.
3. Sekretariat i GPSIE për Inovacion, Shoqëri të Informacionit dhe Politika Sociale është Zyra për Kriteret Ekonomike dhe Tregun e Brendshëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 11

Grupi Punues Sektorial për Integrim Evropian për Transport, Energji, Mjedis dhe Zhvillim Rajonal

1. Në përputhje me nenin 4.2 të këtij vendimi, fushëveprimi i GPSIE për Transport, Energji, Mjedis dhe Zhvillim Rajonal mbulon këto fusha:
 - 1.1. Transporti (neni 113 i MSA-së);
 - 1.2. Energjia (neni 114 i MSA-së);
 - 1.3. Mjedisi (neni 115 i MSA-së);
 - 1.4. Ndryshime klimatike (neni 116 i MSA-së);
 - 1.5. Mbrojtja civile (neni 117 i MSA-së);
 - 1.6. Zhvillimi rajonal dhe lokal (neni 119 i MSA-së).
2. Në përputhje me nenin 4.1 të këtij vendimi, GPSIE për Transport, Energji, Mjedis dhe Zhvillim Rajonal:

3. Sekretariat i GPSIE për Qeverisje është Zyra për Kriteret Politike në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 10

Grupi Punues Sektorial për Integrim Evropian për Inovacion, Shoqëri të Informacionit dhe Politika Sociale

1. Në përputhje me nenin 4.2 të këtij vendimi, fushëveprimi i GPSIE për Inovacion, Shoqëri të Informacionit dhe Politika Sociale mbulon këto fusha:
 - 1.1. Kushtet e punës dhe mundësitë e barabarta (neni 82 i MSA-së);
 - 1.2. Bashkëpunimi social (neni 106 i MSA-së);
 - 1.3. Edukimi dhe trajnimi (neni 107 i MSA-së);
 - 1.4. Bashkëpunimi kulturor (neni 108 i MSA-së);
 - 1.5. Informimi dhe komunikimi (neni 105 i MSA-së);
 - 1.6. Bashkëpunimi në fushën audio-vizuale (neni 109 i MSA-së);
 - 1.7. Shoqëritë informative (neni 110 i MSA-së);
 - 1.8. Rrjetet e komunikimeve elektronike dhe shërbimet (neni 111 i MSA-së);
 - 1.9. Informacioni dhe komunikimi (neni 112 i MSA-së);
 - 1.10. Hulumtimet shkencore dhe zhvillimi teknologjik (neni 118 i MSA-së).
2. Në përputhje me nenin 4.1 të këtij vendimi, GPSIE për Inovacion, Shoqëri të Informacionit dhe Politika Sociale ka këtë përbërje:
 - 2.1. Drejtori i Zyrës për Kriteret Ekonomike dhe Tregun e Brendshëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Kryesues;
 - 2.2. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsim, shkencë dhe teknologji;
 - 2.3. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punë dhe mirëqenie sociale, anëtar;
 - 2.4. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për kulturë, rini dhe sport, anëtar;
 - 2.5. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonomi, anëtar;
 - 2.6. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punë të brendshme dhe administratë publike, anëtar.
3. Sekretariat i GPSIE për Inovacion, Shoqëri të Informacionit dhe Politika Sociale është Zyra për Kriteret Ekonomike dhe Tregun e Brendshëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 11

Grupi Punues Sektorial për Integrim Evropian për Transport, Energji, Mjedis dhe Zhvillim Rajonal

1. Në përputhje me nenin 4.2 të këtij vendimi, fushëveprimi i GPSIE për Transport, Energji, Mjedis dhe Zhvillim Rajonal mbulon këto fusha:
 - 1.1. Transporti (neni 113 i MSA-së);
 - 1.2. Energjia (neni 114 i MSA-së);
 - 1.3. Mjedisi (neni 115 i MSA-së);
 - 1.4. Ndryshime klimatike (neni 116 i MSA-së);
 - 1.5. Mbrojtja civile (neni 117 i MSA-së);
 - 1.6. Zhvillimi rajonal dhe lokal (neni 119 i MSA-së).
2. Në përputhje me nenin 4.1 të këtij vendimi, GPSIE për Transport, Energji, Mjedis dhe Zhvillim Rajonal:

- 2.1. Drejtori i Zyrës për Politikat Sektoriale në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, Kryesues;
 - 2.2. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mjedis, planifikim hapësinor dhe infrastrukturë, anëtar;
 - 2.3. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punë të brendshme, anëtar;
 - 2.4. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për energji, anëtar;
 - 2.5. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për pushtet lokal, anëtar;
 - 2.6. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për zhvillim rajonal, anëtar;
 - 2.7. Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financa, anëtar;
 - 2.8. Përfaqësues nga Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë, anëtar.
3. Sekretariat i GPSIE për Transport, Energji, Mjedis dhe Zhvillim Rajonal është Zyra për Politikat Sektoriale në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Neni 12

Shfuqizimi

1. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen vendimet sikurse në vijim:


- 1.1. Vendimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës nr. 032, i datës 27.08.2008;
- 1.2. Vendimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës nr. 033, i datës 27.08.2008;
- 1.3. Vendimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës nr. 034, i datës 27.08.2008;
- 1.4. Vendimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës nr. 035, i datës 27.08.2008;
- 1.5. Vendimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës nr. 036, i datës 27.08.2008;
- 1.6. Vendimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës nr. 037, i datës 27.08.2008;
- 1.7. Vendimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës nr. 038, i datës 27.08.2008;
- 1.8. Vendimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës nr. 039, i datës 27.08.2008;
- 1.9. Vendimi i Kryeministrit të Republikës së Kosovës nr. 194/10 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit nr. 032, 033, 034, 035, 036, 037, 038 dhe 039, i datës 10.06.2010 dhe;
- 1.10. Vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr.04/59, 05/59, 06/59, 07/59, 08/59, 09/59 dhe 10/59, të datës 01.02.2012.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjitha ministrive (ministrave);
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës;
- Arkivit të Qeverisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/06

Datë: 13.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mbështetje të Ligjit Nr. 06/L-112 për Ratifikimin e Marrëveshjes për Financim midis Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e Ekonomisë Digjitalë të Kosovës - KODE, bazuar në nenin 7 paragrafi 6 e Ligjit Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, si dhe bazuar në kërkesën e ARKEP me nr.prot.657 e datës 11.03.2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Sistemi Nacional për Monitorimin e Spektrit - SNMS, trajtohet si projekt me qëllim të mbrojtjes nacionale.

A r s y e t i m

Projekti Sistemi Nacional për Monitorimin e Spektrit frekuencor - SNMS do të mundësojë monitorimin e brezeve frekuencore të alokuara nga ARKEP për institucionet që kanë të bëjnë me mbrojtjen nacionale, sigurinë nacionale, mirëmbajtjen e rendit publik, shërbimet publike emergjente, mbrojtjen e kufijve shtetërorë, aviacionin civil, sigurinë hekurudhore, si dhe për funksionet tjera komerciale dhe jo-komerciale të shtetit dhe institucioneve të tij.

2. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- ARKEP
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/06
Datë: 13.04.2021

Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 1, të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Nisma e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për negocimin e Marrëveshjes së Amandamentimit nr. 1 të Marrëveshjes Kornizë së Kredisë të datës 14 gusht 2020, ndërmjet Republikës së Kosovës të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Zhvillimore të Këshillit të Evropës (CEB) për financimin e projektit "Reagimi Emergjent ndaj COVID-19".
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/06

Datë: 13.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 46 të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Ri-Aprovohet Raporti Vjetor Financiar për vitin 2020.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi ta dorëzoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës, konform kërkesave të nenit 46 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Thesarit të Kosovës (MF)
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/06
Datë: 13.04.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 6 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, bazuar në nenin 55 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 prill 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Anullohet Vendimi nr.11/52 i datës 24.12.2020, me të cilin Qeveria e Republikës së Kosovës i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës kandidatët për Kryesues të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.


A r s y e t i m

Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2020 kishte dërguar në Kuvendin e Republikës së Kosovës emrat e 3 kandidatëve për kryesues të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë. Mirëpo në mesin e kandidatëve të dërguar për votim në Kuvend ka edhe kandidatë që nuk i përmbushin kriteret e përcaktuara me nenin 6, paragrafi 2, nënparagrafi 3, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Për më tepër, lista e kandidatëve të vlerësuar si të suksesshëm nga Komisioni Rekrutues nuk përkon në tërësi me vlerësimet e dhëna nga ambasada britanike, si partner në procesin e rekrutimit sipas Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut. Madje në raportin e përgatitur nga partnerët britanikë, thuhej se edhe pas përpjekjes për të arritur konsensus, rezultati përfundimtar i komisionit intervistues dhe ai i vëzhguesve të partnerit implementues kishin dallime të mëdha.

Prandaj, me qëllim të rekrutimit të personave të pavarur, profesionalë e me integritet në pozitat e larta të institucioneve dhe organeve publike përmes një procesi të drejtë dhe transparent të rekrutimit, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë